**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA

**KOMUNA E KAMENICËS**
OPŠTINE KAMENICA MUNICIPALITY OF KAMENICA

**Datë:03.10.2024**
Ne bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-2012 i Punës si dhe kërkesës Sh02Nr.30827 të datës: 23.09.2024 të parashtruar nga Udhëheqësi i Shtëpisë së Komuniteteve. Komuna e Kamenicës bën këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 31975
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 04/10
KAMENICË/A 2024

**SHPALLJE PUBLIKE**
Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

**Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Shtëpia Rezidenciale**
**Titulli i pozitës:** Ndihmës/e mjekësor/e Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues/e
**Orar i plotë i punës** 40 orë në javë
**Koeficienti:** H-60 Paga bruto: 393 €
**Lloji i kontratës:** (Marrëveshje për shërbime të veçanta) Periudha e angazhimit: 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Detyrat Kryesore:
Bën kujdesin e përgjithshëm ndaj rezidentit (të varurit,gjysmë të varurit dhe të pavarurit), pastron flokët dhe fytyrën, prenë thonjtë bën ndërrimin e ndërresave të shtratit, rregullimin e shtratit dhe punë tjera të përcaktuara me rregulloren mbi punën me rezident i ushqen klientët e varur. Bashkëpunon me motrat medicinale dhe ndihmon gjatë intervenimeve tekniko-medicinale, kujdeset dhe përgjigjet për pastërtinë e ndërresave personale të shtratit, përgjigjet për higjienën dhe pastërtinë e rrethit ku gjendet si dhe mjetet për për ushqimin e rezidentit. I bartë ndërresat e papastra të rezidentit në lavandëri, bënë trajtimin higjenik të rezidentit të ri, merr klientin në shëtitje,në sallon, në dhomë për qëndrim ditor, në park etj. Përgjigjet për inventar në repart dhe për mjete tjera të besuara, bën dhe punët tjera sipas urdhrit të udhëheqësit.

Kualifikimi: shkolla e mesme.
Përvoja e punës: E dëshirueshme
**Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartë cekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (foto kopje) si vijon:**
- Dëshmi të kualifikimit shkollor në fotokopje
- Dëshmi mbi përvojën e punës,
- Dokumentin e identifikimit.

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Komunën e Kamenicës.

Afati i aplikimit është 8 ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në Web faqen komunale dhe tabelën e shpalljeve. "Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale.
Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kritereve të konkursit përmes emailit ose njoftimit në Web faqe komunale.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Kadri RAHIMA
Kryetar i Komunës